

V E N D I M

Nr. 335 date 23.06.2000

(azhornuar me VKM 228, date 24.5.2002)

PER

RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes se Shqiperise dhe te pikes pikes 2/a te nenit 8, te ligjit nr.7971, date 26.7.1995 "Per Prokurimin Publik", me propozim te zevendesryeministrit dhe minister i Puneve Publike dhe Ceshtjeve Sociale, Keshilli i Ministrave,

V E N D O S I

1. Enti prokurues do te perdore "Tenderin e hapur" ne perputhje me nenin 23, te ligjit nr. 7971, date 26.07.1995 "Per prokurimin publik", kur vlera e perlllogaritur e kontrates eshte mbi 5 (pese) milion leke per prokurimin e ndertimeve, mbi 3 (tre) milion leke per prokurimin e mallrave dhe mbi 1 (nje) milion leke per prokurimin e sherbimeve, me perjashtim te projektiveve, ku si referim te merret vlera e parashikuar per siper marrjen e ndertimit te objektit dhe jo ajo e sherbimit.

Enti prokurues te perdore proceduren "Tender i hapur nderkombetar", kur vlera e perlllogaritur e kontrates eshte mbi 300 (treqind) million leke.

2. Enti prokurues do te perdore "Tenderin e kufizuar" ne perputhje me shkronjen "b" te nenit 18, dhe nenin 36 te ligjit te siperpermendur, kur vlera e perlllogaritur e kontrates nuk eshte me e madhe se 5 (pese) milione leke per prokurimin e ndertimeve, 3 (tre) milione leke per prokurimin e mallrave dhe jo me madhe se 1 (nje) milion leke per prokurimin e sherbimeve, me perjashtim te projektiveve, ku si referim do te merret vlera e parashikuar per siper marrjen e ndertimit te objektit dhe ajo e sherbimit.

Ne kete rast enti prokurues do te siguroje oferta nga jo me pak 3 (tre) kandidate. Per tenderin nderkombetar, enti prokurues do te siguroje te pakten 3 (tre) oferta, nga jo me pak se 3 (tre) shtete te ndryshme.

3. Enti prokures do te perdore "Kerkesen per kuotim" ne perputhje me nenin 22 dhe 40 te ligjit te siperpermendur, kur vlera e perlllogaritur e kontrates te jete jo me madhe se 2 (dy) milione leke per prokurimin e ndertimeve, 1 (nje) milione leke per mallrat dhe 500.000 (peseqind mije) leke per prokurimin e sherbimeve.

4. Enti prokures do te perdore “Prokurimin e drejtperdrejte” ne perputhje me nenin 19 te ligjit te siperpermendur kur:

a) Pika 1/b/c/ç per vlere jo me te madhe se 30 per qind e kontrates fillestare, kur nevoja per kete shtese del gjate kohes se realizimit te kontrates, deri ne 3 muaj pas perfundimit te saj.

b) Pika 2, per prokurimet me vlere te vogel, kur vlere e perlllogaritur e prokurimit per çdo artikull ose ze nuk eshte me e madhe se 300 (treqind) mije leke brenda nje viti kalendarik. Me artikull, ne kuptim te ketij vendimi, do te kuptohet nje grup mallrash, qe kane te njejtin emer dhe funksion kryesor.

c) Per Drejtorine e Sherbimeve Qeveritare vlere e perlllogaritur e blerjes per çdo artikull nuk eshte me e madhe se 600.000 (gjashteqind mije) leke, brenda nje viti kalendarik.

ç) Entet prokuruese, per plotesimin e nevojave te fillimit te cdo viti, lejohen te lidhin kontrata shtese me kontraktuesit e tyre te fundit per mallrat apo sherbimet. Kjo kontrate shtese do te jete e vlefshme vetem per periudhen deri ne daten e nenshkrimtimit te kontratave, per fondet e vena ne dispozicion.

5. Dita e shpalljes se fteses per oferte deri ne ditën e dorezimit te saj te jete:

a) Per “Tenderin e hapur” te jete jo me pak se 20 (njetete) dite per prokurimin e ndertimeve, te mallrave dhe te sherbimeve.

b) Per “Tenderin e kufizuar” jo me pak se 15 (pesembedhjetë) dite prokurimin e ndertimeve, te mallrave dhe te sherbimeve.

c) Per “Kerkesen per kuotim” jo me pak se 10 (dhjete) dite per prokurimin e ndertimeve, te mallrave dhe te sherbimeve.

d) Per procedurat nderkombetare jo me pak se 45 (dyzetepese) dite.

6. Kushti i sigurimit te ofertave, ne forme garancie bankare, sipas nenit 29 te ligjit, do te jete 2 (dy) - 5 (pese) % (per qind) e vleres se perlllogaritur te kontrates (e llogaritur paraprakisht nga enti prokurues dhe e dhene ne vlere absolute ne te dhenat e ofertes), kurse kushti i sigurimit te kontrates do te jete 10 (dhjete) % (per qind) e vleres se kontrates.

7. Enti prokurues, perpara se te shpalle oferten ose propozimin fitues, te paraqese per shqyrtim paraprak e miratim raportin permbledhes te prokurimeve:

a) Te titullari i entit prokurues per te gjitha prokurimet me vlere jo me te madhe se 5 (pese) milione leke.

b) Te titullar i organit, qendror ose vendor, per prokurimet me vlere mbi 5 (pese) milion leke, por jo me madhe se 100 (njeqind) million leke.

c) Ne Agjencine e Prokurimit Publik per prokurimet me vlere mbi 100 (njqind) milione leke.

8. Pjesemarresi ne tender i shpallur fitues duhet t'i konfirmoje entit prokurues, nepermjet nenshkrimit te formularit te kontrates, gatishmerine per te lidhur kontraten brenda 15 diteve nga marrja e njoftimit, per tenderin e hapur dhe te kufizuar, dhe fteses per kuotim dhe per tenderin e hapur dhe te kufizuar nderkombetar.

Ne rast se brenda ketij afati, pergjigjja nga pjesemarresi fitues eshte negative, entit prokurues i lind e drejta te njoftoje per negociimin e kontrates pjesemarresin qe eshte renditur i dyti ne klasifikim dhe njekohesisht te beje konfiskimin e sigurimit te ofertes per pjesemarresin fitues.

9. Enti prokurues eshte i detyrar te krijoj regjistrin e prokurimeve ne fillim te çdo viti, ku te shenohet rregullshmeria e zbatimit te procedurave te prokurimit.

10. Te gjitha entet prokuruese te dergojne per botim ne Agjencine e Prokurimit Publik ftesen per oferte per "Tender i hapur", "Tender i kufizuar" dhe "Kerkese per kuotim", jo me vone se 10 dite perpara shpalljes se saj, me perjashtim te te rasteve te perdorimit te procedures se prokurimit, sipas pikes 3 te nenit 17 te ligjit nr. 7971, date 26.7.1995 "Per Prokurimin Publik ...". Gjithashtu per tenderat qe do te botohen ne Buletinin e Prokurimit Publik enti prokures eshte i detyruar qe perpara lidhjes se kontrates te beje njoftimin e fituesit ne Buletinin e Prokurimit Publik.

11. Entet prokuruese, brenda dates 30 Janar, te paraqesin ne Agjencine e Prokurimit Publik statistika te sakta per planifikimin vjetor te prokurimeve. Gjithashtu, te paraqiten prane Agjencise se Prokurimit Publik edhe ndryshimet e planit te prokurimeve publike gjate vitit kalendarik. Entet prokures, ne fund te çdo 4-mujori, brenda dates 20 te muajit pasardhes te paraqesin ne Agjencine e Prokurimit Publik nje tregues per realizimin apo jo te prokurimeve te planifikuara, te shoqeruar me relacionin shpjegues. Per realizimin e kesaj detyre, titullari i entit prokurues ngarkon njesine e prokurimit (nese ka) apo strukturen pergjegjese, qe planifikon fondet e prokurimeve te entit. Agjencia e Prokurimit Publik, nga ana e vet, brenda dates 30 te po atij muaji duhet te paraqese ne Keshillin e Ministrave nje pasqyre permbledhese te prokurimeve ne shkalle vendi.

12. Per nje veprim apo mosveprim te kryer nga nje ent prokurues, te cilin nje kandidat e vlereson si shkelje te ligjit ose te rregullave te prokurimit, ai eshte i lire te beje shqyrtim administrativ, brenda ketyre afateve :

a) ne entin prokurues brenda 5 (pese) diteve mbas shpalljes se klasifikimit perfundimtar te ofertave;

b) ne organin, qendror apo vendor, i cili ve ne dispozicion fondin, brenda 5 (pese) diteve pas mbarimit te afatit te ankeses prane entit prokurues; Organi, qendror apo vendor, eshte i detyruar te ktheje pergjigje brenda 10 diteve nga marrja e ankeses.

c) ne Agjencine e Prokurimit Publik brenda 5 (pese) diteve pas marrjes se pergjigjes nga organi, qendror apo vendor, qe ve ne dispozicion fondin.

13. Ne rastet kur nje proçedure prokurimi kthehet per rivleresim nga Agjencia e Prokurimit Publik, enti prokurues eshte i detyruar qe brenda 5 (pese) diteve nga marrja e ketij vendimi te paraqese ne Agjencine e Prokurimit Publik raportin permbledhes te rivleresimit.

14. Enti prokurues duhet te ruaje dhe te vere ne dispozicion te organeve te kontrollit regjistrin e prokurimeve, proçes-verbalet dhe dokumentacionin e plote te te gjitha prokurimeve te kryera. Ruajta e ketij dokumentacioni te behet ne perputhje me afatet e percaktuara ne ligjin “Per arkivat”.

15. Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 12 date 01.01.1996 “Per Rregullat e Prokurimit Publik” shfuqizohet.

Ky Vendim hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne fletoren zyrtare.

**KRYEMINISTRI
ILIR META**

ZEVENDESKRYEMINISTER DHE
MINISTER I PUNES DHE CESHTJEVE SOCIALE

MAKBULE CECO